

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), dhe Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nenit 3 pika 1.2, neni 5, neni 7 dhe 8, neni 12 pika 2, neni 13 pika 2, si dhe Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës nr. 1450/1 dt. 08.08.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i NP "Termokos" Sh.A në Prishtinë, me datë: 29.05.2025, shpallë:

**KONKURS I BRENDSHËM
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS**

Pozita: Ndihmës i Drejtorit të Departamentit të distribuimit - një (1) vend pune

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Departamentit të distribuimit

Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të caktuar

Lartësia e pagës mujore: Përcaktohet në përputhje me rregulloret e brendshme ekonomiko - financiare të NP "Termokos" Sh.A., si dhe aktet ligjore përkatëse në fuqi

Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Bashkëpunon me Drejtorin e Departamentit për përbushjen e objektivave dhe planeve të departamentit;
- Është pjesëmarrës në të gjitha pranimet teknike për termopërquesit dhe termonënstantacionet e ngrohjes dhe instalimeve shtëpiake dhe është përgjegjës, që të gjitha parregullsitë teknike të vërejtura t'i shënojë në procesin mbi pranimin teknik dhe me shkrim ta njoftojë drejtorin e departamentit;
- Sipas dakordimit me drejtorin, menaxhon me vartësit e departamentit dhe siguron, që të gjitha shërbimet lidhur me furnizimin me ngrohje të kryhen në mënyrë profesionale dhe efektive;
- Ndihmon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve normative të ndërmarrjes;
- Përcjell për çdo ditë problemet dhe reklamimet në rrjetin e shpërndarjes, jep urdhëresa punëtorëve përgjegjës dhe vërteton bashkërisht apo personalisht shkakun e reklamimit të problemeve specifike nga ana konsumatorëve;
- Është i obliguar dhe ka të drejtë të jap mendime dhe ide profesionale për zgjidhjen e problemeve teknike me qëllim të rritjes së performancës dhe stabilitetit të rrjetit të distribucionit;
- Bashkëpunon me drejtorin e departamentit, që të kujdeset dhe bëj plane për ngritjen profesionale të punëtorëve, si dhe jep sugjerime për sistemimin e tyre në pozita adekuate;
- Është përgjegjës për mbledhjen e shënimeve dhe formimin e databazës së shënimeve për intervenimet ditore dhe gjendjen e përditshme të instalimeve të ngrohjes;
- Është përgjegjës për identifikimin e lidhjeve ilegale dhe shfrytëzimin e paautorizuar të ngrohjes;

- Bashkëpunon ngushtë edhe me departamentet tjera, në mënyrë që ndërmarrja të funksionojë në mënyrë sa më efikase dhe të dobishme;
- Është përgjegjës për vartësit e departamentit dhe siguron, që të gjitha shërbimet lidhur me furnizimin me ngrohje të kryhen në mënyrë profesionale dhe efektive;
- Siguron zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore;
- Mbi punën e kryer raporton në baza ditore, javore dhe mujore tek drejtori i departamentit;
- Evaluimi i performancës i bëhet çdo vit;
- Kryen edhe punët tjera, të cilat delegohen nga drejtori i departamentit.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale:

- Bachelor/Fakulteti Inxhinierisë Mekanike.
- Së paku (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- Njohja e gjuhes angleze obligative.
- Njohje e mirë e punës me kompjuter (Microsoft Office).
- Aftësi të larta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.
- Nivel i lartë i iniciativës dhe angazhimit.
- Mënyrë e strukturuar, e pavarur dhe e zellshme e punës.
- Aftësitë organizative.
- Besueshmëri.

Aplikantët e interesuar për vendin e punës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

1. Aplikacionin e plotësuar dhe të nënshkruar;
2. CV e aplikantit;
3. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
4. Dëshminë mbi përvojën e punës (të dëshmohet përmes kontratës së punës ose trustit).
5. Dëshminë nga gjykata kompetente, që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
6. Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar
7. Kopje të certifikatave, referencave tjera profesionale, që ndërlidhen me pozitën që aplikoni.

Mënyra e aplikimit: Kandidatët mund ta shkarkojnë aplikacionin për punësim, që gjendet në ueb faqen e NP "Termokos": www.termokos.org;

I tërë dokumentacioni duhet të skanohet dhe dorëzohet në formë elektronike. Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në mënyrë elektronike në emailin: burimet.njerezore@termokos.org. Pas dërgimit të email-it, ju do të pranoni konfirmimin nga ne. Nëse nuk keni pranuar konfirmimin, atëherë kontaktoni në nr. tel 038 541-780.

Konkursi i brendshëm do të jetë i hapur në afat prej 15 ditësh nga data e publikimit në ueb faqe www.termokos.org.

Mbyllja e konkursit bëhet më datë: 13.06.2025, ora 24.00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mbanë përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

1. Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet intervistimit, testit me gojë;
2. Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë;
3. Intervista vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë.

Kalendari i përafërt: Bazuar në UA 01/2024 nenin 7 pikë 1.11, procedura e përafërt e rekrutimit do të përfundojë brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.